

ÇFARË U NEVOJITET FËMIJËVE ?

Fëmijët e meritojnë maksimumin e asaj që mund ta ofrojmë. Fëmijët e vegjël e meritojnë më të mirën, që nga fillimi i jetës së tyre. Të gjithë ne pajtohemi me këtë parim i cili është një bazë e mirë prej nga mund të fillojë mësimdhënja për fëmijët. Megjithatë, nuk mjafton vetëm ky parim për ardhur deri tek pikëpamjet e qëndrueshme. Mësimdhënësit duhet t'i kenë të qarta nevojat e fëmijëve.

Pikëpamja **empirike** për fëmijën i konsideron fëmijët si një enë boshe të cilën duhet ta mbushë mësuesi. Ata të cilët pajtohen me këtë pikëpamje, e shohin rolin e mësuesit si identifikues të përvojave, shkathtësive, dhe koncepteve që i mungojnë fëmijës, dhe si transmetues të këtyre tek fëmija. Një pikëpamje e këtillë e kërkon nga mësuesi që ta copëzojë të nxënin në faza të lehta hap pas hapi. Fëmijët poashtu mësojnë si ta përmbushin një rol të caktuar në shoqëri.

Pikëpamja **natyraliste** për fëmijën konsideron se të gjithë njerëzit lindin me aftësi dhe prirje të caktuara të cilat zhvillohen në mënyra të caktuara, varësisht nga rrethanat e mjedisit. Pikëpamja natyraliste ndaj arsimit nënkupton se mësimdhënësi nuk është burimi i tërë njohurive të fëmijës. Fëmija duhet të luajë dhe ta zhvillojë kreativitetin e imagjinatës. Mësimdhënësi duhet të dijë si të tërhiqet dhe ta respektojë zhvillimin e fëmijës.

Është problematike nëse mësimdhënësit e shohin fëmijën vetëm nga njëri këndvështrim. Që të kuptohen nevojat e fëmijëve, duhet të përfillen aspektet e të dy teorive.

Pikëpamja **interaktive** e merr parasysh rolin kritik të të rriturit. I rrituri, sipas kësaj pikëpamjeje, nuk është vetëm dhënësi i diturisë por është edhe model sipas të cilit fëmijët e ndërtojnë strategjinë e vet. Fëmijët nuk janë të vetmuar në mjedisin përkatës, ata mësohen ta shfrytëzojnë mjedisin me ndihmën e të rriturve.

Bruce (1987, f.10) i përmbledh parimet kryesore të tri teorive kryesore e më me ndikim për arsimin e fëmijës, Froebel, Montessori, dhe Steiner:

1. *Faza e fëmijërisë është e veçantë*, me fjalë të tjera nuk është thjesht një përgatitje për moshën e rritur. Mirëpo, sa më e larmishme dhe e pasur të jetë fëmijëria, aq më shumë mund të shërbejë në jetën e mëvonshme.
2. *Fëmija është i rëndësishëm si tërësi*, pra si nga aspekti fizik, edhe nga ai mendor dhe shpirtëror.
3. *Të nxënin nuk është i ndarë*, gjithçka në jetën e fëmijës është e ndërlidhur, si në shtëpi ashtu dhe në shkollë.
4. *Motivimi i brendshëm ka shumë vlerë*, me fjalë të tjera, aktivitetet e inicuar nga vetë fëmija.
5. *Vetë-disiplina ka theks të veçantë*, dhe rezulton kur nuk cenohet motivimi i brendshëm
6. *Të gjitha fazat e zhvillimit të fëmijës karakterizohen me aftësi të ndryshme të të nxënin*, dhe secila fazë duhet të zhvillohet natyrshëm, pa përshpejtime.

7. *Edukimi fillon nga ajo që mund ta bëjnë fëmijët, prandaj mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshëm që të përqëndrohen në përparsitë e jo në mangësitë e fëmijës.*
8. *Njohuritë dhe të kuptuarit e fëmijës zhvillohet nëse ka nxitje të duhur: roli i të rriturve është që ta përpunojnë dhe ta transmetojë njohurinë.*
9. *Njerëzit (të rriturit dhe fëmijët) me të cilët komunikon fëmija janë shumë të rëndësishëm.*
10. *Edukimi i fëmijës është ndërveprim i fëmijës me mjedisin, me të tjerët, dhe me vetë njohuritë.*

ÇFARË MUND TË BËJNË FËMIJËT

Të gjithë fëmijët janë të ndryshëm. Mësimdhënësi i fëmijëve të vegjël duhet të jetë në gjendje t'i kuptojë dhe të punojë me dallimet individuale në zhvillimin e fëmijëve, me njohuritë dhe aftësitë e ndryshme, me shpejtësinë e të nxënimit dhe me interesimet e llojllojshme.

Një varg faktorësh të mjedisit mund të bëjnë ndikim tek fëmijët: koha kur ndodh aktiviteti, lloji i aktivitetit, familjariteti me kontekstin dhe me njerëzit, si dhe me raportet shoqërore.

Jashtë shkollës fëmijët mësojnë nga përvoja e vërtetë jetësore, në kontekste kuptimplota apo në kontekste të cilat ua sqarojnë të tjerët. Fëmijët janë kureshtarë për botën që i rrethon, për njerëzit dhe veprimet e tyre, dhe e kanë përfytyrimin e vet për të gjitha këto. Ata fillojnë t'i zhvillojnë shkathësitë elementare dhe strategjitë për të marrë pjesë në këtë botë dhe për ta shijuar atë. Ata kanë filluar të zhvillojnë pikëpamje të caktuara për vete dhe të tjerët.

Mësimdhënësi që i ka parasysh kontekstet e caktuara që ndikojnë tek fëmijët, e ka më të lehtë ta planifikojë pikënisjen e procesit të të nxënimit.

Për shembull, mësuesi mund të planifikojë të flasë për ujin. Në rradhë të parë ai/ajo duhet t'i identifikojë njohuritë e fëmijëve për ujin në atë vend të caktuar- p.sh. në Slloveni.

UJI

Çfarë mund të dijnë fëmijët?

Ljubljana

Shiu

Lumi

Ura

Çesma

Bazeni

Për se mund të flasin fëmijët?

Mund të flasin për rrobat e shiut

Mënyrën se si kalohet lumi

Uji që shërben për gatim

Notimi

Cerknica

Uji i ngrirë

Zhdukja e ujit

Ujitja

Patinazhi

Efektet e ndërrimit të stinëve tek uji

Uji si ushqim i bimëve

Koper

Deti

Turizmi

Puna me fëmijët është e mundimshme, komplekse, nganjëherë frustruese, dhe të shumtën e rasteve me rezultat.

Raporti Rumbolt *Të fillojmë me cilësi*, i botuar nga Departamenti i Arsimit dhe Shkencës në Angli në 1990, e hulumton ofrimin e arsimit cilësor për fëmijët. Raporti (f.47) i përshkruan disa cilësi të cilat duhet t'i kenë mësimitdhënësit e fëmijëve në mënyrë që të ofrojnë arsim të cilësisë të lartë.

Njohuritë dhe të kuptuarit

- *Të kuptuarit se si nxënë fëmijët*, që demonstron me planifikimin e bazuar në këtë aspekt
- *Të kuptuarit e rëndësisë së lojës dhe raportit të saj me mësimin*
- *Të kuptuarit e procesit të të nxënimit të gjuhës dhe dallimi mes asaj që e mëson dhe asaj që e përvetëson fëmija*
- *Të kuptuarit e rolit të prindërve si edukatorë*
- *Njohuria dhe të kuptuarit e nevojave të fëmijëve*
- *Njohuria për përvojat parashkollore të fëmijëve*

Shkathtësitë

- *Shkathtësitë e vrojtimit*
- *Shkathtësitë organizative*, që mundësojnë lloje të ndryshme të të nxënimit
- *Shkathtësitë interaktive dhe komunikative*, që mundësojnë të trajtohen fëmijët si individë dhe si grup
- *Shkathtësitë për bashkëpunim me kolegët, prindërit, dhe fëmijët*
- *Shkathtësitë për të ofruar shansin e njëjtë të gjithë fëmijëve*, ashtu që të pranohen dhe të çmohen ndryshimet

Pikëpamjet

- *Dashuria dhe respekti i sigurtë për fëmijët*
- *Vlerësimi i lartë për fëmijët dhe vetëveten*, që nënkupton se fëmijët e ndryshëm kanë potenciale të ndryshme
- *Vlerësimi i rolit të të rriturëve të tjerë*, duke përfshirë dhe prindërit, personelin e shkollës, si dhe profesionistët e tjerë

ORGANIZIMI I KLASËS

Mësimdhënësi me pikëpamje interaktive për të nxënimit e fëmijës, dëshiron që të ofrojë një sërë mundësish të të nxënimit në klasë.

- Lojën
- Aktivitetet praktike
- Aktivitetet shoqërore
- Aktivitetet individuale
- Inkurajimin e pavarësisë së fëmijëve duke u dhënë atyre mundësinë për të zgjedhur

- Mundësinë për t'i shfaqur interesimet e veçanta të fëmijëve

Mënyrat e organizimit të këtyre rrethanave janë të ndryshme. Mund të merren parasysh aspektet fizike në klasë, hapsira dhe mjetet didaktike, ashtu si dhe politika dhe etika shkollore.

Mësimdhënësi mund të përdorë disa mënyra mësimi gjatë një dite.

Shpjeguese	Mësimdhënësi i jep informatë tërë klasës
Bisedore	Zhvillohen biseda në grupe
Pyetëse	Fëmijët kanë mundësi të zgjedhin dhe të eksperimentojnë
Aktive	Fëmijët i përdorin njohuritë dhe shkathtësitë e veta

Metodat e përdorura ndikojnë në organizimin e klasës.

Parimet që i rradhit Bruce kanë peshë nga aspekti i konteksteve që i krijojmë për organizimin e procesit të të nxënit. Klasa është vendi ku realizohet procesi i të nxënit i planifikuar nga mësimdhënësi. Klasa organizohet, planifikohet, dhe pajiset, duke e pasur parasysh fëmijën.

“Është një ambient të cilin fëmijët duhet ta shohin si të vetin, dhe për të cilin duhet të ndjejnë përgjegjësi. Për ta gjithëçka është e vërtetë dhe e tyre. Duhet të sigurohemi se ambienti është tërheqës dhe i këndshëm për fëmijët ashtuqë ata të mund të ndjejnë kënaqësi në të. Asgjë nuk guxon të mungojë, të jetë e thyer apo e papërdorshme, ashtuqë fëmijët të binden se gjithçka në klasë është për ta, e gatshme për ta përdorur ata.”

Hall (1994)

LOJA NË KLASË

Fëmijët e vegjël kanë qef të luajnë dhe të flasin për lojën. Loja luan rol të rëndësishëm në procesin e të nxënit. Loja është interaktive dhe shoqërore. Loja bëhet pa presion. Loja është simbolike. Nëpërmjet lojës fëmijët inicojnë ide dhe situata, marrin vendime, planifikojnë, gjejnë alternativa, zgjidhin probleme, hulumtojnë, dhe i shpjegojnë idetë e veta. Këto të gjitha janë tipare të rëndësishme të procesit të të nxënit që u nevojitet nxënësve ta zbatojnë në jetë. Fëmijët e konstruktojnë njohurinë e vet dhe të kuptuarit e botës me anë të këtyre proceseve. Nëse mësimdhënësit e përdorin lojën në kontekst të kurikulimit, kjo mund ta shtojë suksesin në mënyrë të konsiderueshme.

Ka pikëpamje të ndryshme për lojën në klasë. Disa mësimdhënësit ofrojnë një kontekst për aktivitetet e lojës, të bindur se loja është më kuptimplotë kur fëmijët e lidhin me diçka. Të tjerët mund të ofrojnë aktivitete të lojës jashtë kontekstit, duke besuar se fëmijët duhet të zhvillojnë ide dhe tema të veta gjatë lojës.

Hapsira e lojës mund të jetë klasa apo ndonjë hapsirë tjetër ku gjenden fëmijët dhe mësimdhënësit.

Loja mund të përfshijë një varg aktivitetesh, si vijon më poshtë, dhe mësuesi mund të vendosë se çfarë është më e përshtatshme për një kohë të caktuar:

- Loja imagjorative/ loja me role, p.sh. brenda shtëpisë, apo në një dyqan
- Arte dhe zeje, p.sh. vizatim, kolazh, apo vizatim me shkumës
- Konstrucion, qoftë në përmasa të mëdha apo të vogla
- Hulumtim, p.sh. me dhe, dhe me ujë

- Aktivitete nëpër tavolina, p.sh. kombinime pjesëzash
- Aktivitete leximi dhe shkrimi që mund të përfshijnë zhanre të ndryshme letrare dhe materiale të ndryshme shkrimi
- Matematikë, p.sh. aktivitete me trajta të ndryshme apo me koncepte kohore
- Aktivitete muzikore, p.sh. due përfshirë instrumente me goditje dhe një kasetofon
- Aktivitete me kompjuter duke përdorur programe të përshtatshme

Roli i mësimdhënësit gjatë lojës është të:

- **Planifikojë** kurikulin, duke e paraparë strukturën e aktiviteteve
- **Zbatojë** kurikulin, duke e paraparë ndërhyrjen e mësuesit, që nënkupton pjesëmarrjen, modelimin, pyetjet, nxitjet, përfshirjen, dhe vëzhgimin
- **Vlerësojë dhe regjistrojë** të nxënit
- **Vlerësojë** efikasitetin

TË NXËNIT E HERSHËM TË SHKRIM-LEXIMIT

Në një shoqëri të shkolluar, fëmijët e njohin shkrim-leximin. Ata kanë përvoja të ndryshme, njohuri dhe shkathtësi të ndryshme në të gjitha fushat e kurikulit. Mësuesit duhet ta zbulojnë atë që e di secili individ në klasë që pastaj ta planifikojë kurikulin në mënyrë adekuate.

Frank Smith (1971) e përshkruan Klubin e Shkrim-Leximit, ku anëtarësohen të gjithë të riturit që njohin shkrim dhe lexim. Fëmijët dëshirojnë të anëtarësohen në këtë klub që të komunikojnë me fjalën e shkruar. Fëmijët besojnë se shkolla e ofron anëtarësinë në këtë Klub të Shkrim-Leximit. Roli i mësimdhënësit është t'i ofrojë fëmijës anëtarësinë në këtë klub.

Një urë e rëndësishme mes përvojës gojore të fëmijërisë dhe shkrim –leximit është rrëfimi i tregimeve.

Rrëfimi i tregimeve:

- U prezanton fëmijëve magjinë e fjalëve
- U ndihmon fëmijëve ta kuptojnë konceptin e narracionit
- I inkurajon fëmijët të lexojnë në mënyrë të pavarur
- U ndihmon fëmijëve të zhvillojnë idetë e tyre për raportet mes tregimit dhe fjalës së shkruar

Fëmijët duhet të kenë një qëllim shkrimi. Mësuesi duhet të mendojë për qëllimet e shkrimit që i dijnë fëmijët dhe duhet të ofrojë burime dhe mundësi që ata të zhvillojnë shkathtësinë e tyre të shkrimit.

Mësuesit duhet t'u ndihmojnë fëmijëve t'i kuptojnë dallimet mes fjalës së shkruar dhe asaj të folur. Shkrimet e fëmijëve duhet të botohen për një publik më të gjërë, dhe jo vetëm për mësuesin. Të folurit dhe përvoja duhet të shihen si pararendëse dhe shoqëruese të shkrimit.

Mësuesit duhet t'i inkurajojnë të gjithë fëmijët ta konsiderojnë veten si lexues dhe shkrimtarë aktivë dhe entuziastë.

Referencat

- Abbot, L&Rodger, R (Redaktorë), 1994. Arsimi Cilësor në vitet e hershme. Open University Press
- Anning, A. 1997. Vitet e para në shkollë. Open University Press (Botimi i dytë)
- Bruce, T. 1987. Arsimi në fëmijrinë e hershme. Hodder & Stoughton
- David, T (Redaktor) 1993. Arsimi për fëmijët tanë të vegjël- Perspektiva evropiane. Paul Chapman Publishing
- Edwards, A& Knight, P. 19945. Arsimi efikas në fëmijri. Open University Press.
- Hall, J. 1994. Edukimi mon tessor, Britani e Madhe
- Mozless, J.R. 1989. Vetëm lojë? Open University Press.
- Smith, F. 1971. Të kuptuarit e leximit. Holt, Rinehart & Winston.

Perkthyer nga: Lindita Tahiri

Perkthimi u mundesua nga Granti i Komisionit te Demokracise te U.S.